



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 35 Prot.

Tiranë, më 09.01.2024

V E N D I M

Nr. 8 , Datë 09 . 01 . 2024

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ mori në shqyrtim ankesën nr. 101 Regj., datë 30.05.2023, të paraqitur nga ankuesja znj. R.N (në vijim ankuesja), kundër Bashkisë Vlorë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (në vijim MFE), me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjendjes arsimore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet e bëra nga ankuesja në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ndër të tjera, ajo deklaroi se, ka nisur punë për herë të parë në arsim me datë 15.09.1988 dhe vazhdon të punojë prej 35 vite punë pa shkëputje. Ankuesja shpjegon se, ka përfunduar studimet në vitin 2006-2009 në arsimin parashkollor dhe është diplomuar me titull “Mësuese në Arsimin Parashkollor” (DNP) dhe gjatë viteve 2010-2011 ka fituar titullin “Master Profesional”. Ankuesja informon se ka marrë të treja kategoritë e kualifikimit III, II, I.

Znj. N. shpjegon se, në tetor 2022, si e renditur e para në Portal, me lëvizje paralele në ZVA Vlorë-Himarë, ka marrë kontratën me afat të pacaktuar në Kopshtin Nr. 2 “Sulo Didi” në Bashkinë Vlorë. Ajo është shkëputur nga puna nga Kopshti “28 Nëntori” në Bashkinë Berat në datën 29.09.2022 dhe ka filluar punë në Kopshtin Nr.2, në Bashkinë Vlorë në datën 03.10.2022.

Ankuesja informon se, në Bashkinë e Beratit është paguar me pagën e grupit 14. 000 lekë. Në momentin e punësimit në Bashkinë Vlorë, i është bërë ndryshimi i pagës së grupit nga 14. 000 lekë në 11. 000 lekë, me pretendimin se gjen zbatim VKM nr.175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”.

¹ Në vijim do t’i referohemi Komisioneri.

Në lidhje me këtë problematikë, ankuesja deklaroi se i është drejtuar zyrtarisht Qendrës Ekonomike dhe Kryetarit të Bashkisë Vlorë, por nuk ka marrë përgjigje me shkresë. Ndërsa ka paraqitur ankesë edhe tek Portali *Shqipëria që Duam*, por nuk ka marrë një përgjigje sqaruese. Në përgjigjen që ka marrë është cituar vetëm ligji dhe VKM, por jo një interpretim i tyre.

Sipas ankueses, kolege të tjera të saj që kanë lëvizur me Portal, sikurse në rastin e saj, por në bashki të tjera, nuk kanë patur ndryshime në pagë, por vazhdojnë me të njëjtën pagë dhe disponojnë të njëjtën diplomë si ajo. Ankuesja pretendon se, bazuar në ligjin nr. 69/2012 ajo disponon diplomën e kërkuar për mësuesin në arsimin parashkollor dhe se bazuar në VKM nr.175, datë 08.03.2017, ajo nuk është emëruar në punë pas datës 01 Mars 2017, por ka qenë në marrëdhënie pune dhe duhet të vazhdojë të përfitojë të njëjtën pagë grupi, pra 14 000 lekë. Ankuesja shpjegon gjithashtu se, kur ka ndryshuar paga e grupit nga 14. 000 lekë në 11. 000 lekë, ndryshojnë edhe shtesa e pozicionit, shtesa për vjetërsi, shtesa për vështirësi, dhe se, në çdo shtesë page që bëhet ndryshon dhe vlera. Ankuesja pretendon se, vetëm në Bashkinë Vlorë interpretohet dhe zbatohet në këtë mënyrë VKM nr. 175, datë 08.03.2017. Ankuesja pretendon se ndihet e diskriminuar në krahasim me pjesën tjetër të mësuesve/edukatoreve, pasi kjo situatë është krijuar vetëm në Vlorë.

Ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të merren masa për zgjidhjen e këtij problemi dhe situatës së krijuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar², që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*gjendjes arsimore*”, duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 7, i LMD-së, parashikon shprehimisht: “*1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që*

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun II, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, të tij parashikon se: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”*

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Për sa më lart, referuar nenit 33, të LMD-së, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 665/4 prot., datë 19.06.2023, Komisioneri, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Bashkisë Vlorë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga ankuesja. Nëpërmjet të njëjtës shkresë Komisioneri ka kërkuar informacion në lidhje me pretendimet e ngritura nga pala ankuese edhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
2. Me shkresën Nr. 3864/1 prot., datë 22.06.2023 Ministria e Arsimit dhe Sportit, informoi ndër të tjera se:
“Në ligjin nr. 69, datë 21.06.2012 “Për Sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 2, pika 1, përcaktohen nivelet arsimore të arsimit parauniversitar si vijon: Arsimi parauniversitar përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas “Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit”, të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997 përkatësisht:

- a) “Niveli me kodin 0”, arsimit parashkollor;
- b) “Niveli me kodin 1”, arsimit fillor;
- c) “Niveli me kodin 2”, arsimit mesëm i ulët;
- ç) “Niveli me kodin 3”, arsimit mesëm i lartë.

Arsimi parashkollor synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor. Arsimit parashkollor ndiqet nga fëmijët e moshës nga tre deri në gjashtë vjeç. Fëmijëve të moshës pesë vjeç u mundësohet ndjekja e klasës përgatitore edhe pranë shkollave të arsimit bazë, me synim integrimin në arsimin e detyruar. Arsimit parashkollor ofrohet nga kopshti, si institucion arsimor.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për qeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 23, pika 12, bashkitë janë përgjegjëse për administrimin dhe rregullimin e sistemit parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Me urdhrin e Kryeministrit nr. 127, datë 16.09.2015 “Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, numri i punonjësve mësimorë, edukatorë të arsimit parashkollor, numri i punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, si dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve të punonjësve mësimorë, edukatorë të arsimit parashkollor, punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, janë transferuar pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Ligji nr. 69/2012, përpara miratimit të ndryshimeve me ligjin nr. 48/2018, në nenin 57, pika 1, germa a), përcaktonte: Neni 57

1. Mësuesi në institucionin arsimor duhet të ketë fituar diplomën e mëposhtme në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të: a) Mësuesi i arsimit parashkollor: diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare Bachelor.

Me ndryshimet e ligjit nr. 69/2012, të miratuara me ligjin nr. 48/2018, datë 23.7.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet që mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor. Pra, duke filluar nga viti 2018 e në vazhdim, bazuar në ligjin nr. 48/2018, datë 23.07.2018, neni 57, pika 1, germa a), një kandidat për tu pranuar, emëruar dhe punësuar si mësues i arsimit parashkollor, dmth në kopsht duhet të zotërojë diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, në mësues për arsimin parashkollor.

Ndërsa sipas pikave 2-5, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012, për të ushtruar profesionin e rregulluar të mësuesit të arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë, së pari kërkohet që të ketë ndjekur dhe përfunduar arsimin e lartë në dy ciklet e studimit duke fituar një diplomë të ciklit të parë dhe një diplomë të ciklit të dytë, më pas të kryej praktikën profesionale si dhe të kalojë me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Në lidhje me nivelet e diplomave të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 124, pika 1, parashikon:

“Neni 124

1. Diplomat e programeve të studimit, që kanë zgjidhur 3 vite (6 semestra), janë ekuivalente me diplomat “Bachelor”.

Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mund të paraqesë parashtrime për mënyrën e zbatimit të VKM nr. 175, datë 08.03.2017, lidhur me rastin konkret pasi subjekti ankues punon në kopsht, pra në një institucion arsimor të arsimit parashkollor, i cili rregullohet dhe administrohet nga Bashkia Vlorë...”.

3. Në përgjigje të shkresës së Komisionerit, Bashkia Vlorë përmes shkresës nr. 7371/1, datë 17.07.2023, informoi ndër të tjera se:

“Znj. R.N, është emëruar edukatore në kopshtin nr.2, Bashkia Vlorë dhe për pagën e saj është zbatuar pika 3.a e VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar për pagën e grupit.

Bashkia Vlorë, nisur nga ankesa e edukatores, me pretendimin e pabarazisë në nivelin e pagës, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për interpretim të VKM-së nr. 175, me shkresat nr. 1024 datë 25.01.2023 dhe 1024/2, datë 16.03.2023. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka kthyer përgjigje me shkresat nr. 1024/1, datë 08.02.2023 dhe nr. 1024/3, datë 29.03.2023.

Në rastin e znj.N. nuk ka ndryshim /ulje në pagë sepse është emërim i ri në institucionet arsimore të Bashkisë Vlorë.

Znj. N. nuk është ankuar për diskriminim pranë punëdhënësit, por ka kërkuar shpjegime mbi pagën e grupit....”.

4. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 665/4 prot., datë 30.08.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Lidhur me trajtimin me sa më objektivitet të çështjes, si dhe në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor, Komisioneri ka kërkuar paraprakisht, që palët në proces të sjellin informacion, prova, si dhe fakte të reja, që mund të mbështesin pretendimet e tyre, lidhur me sa më sipër.

Seanca u zhvillua në datë 12.09.2023, me praninë e ankueses, e cila mori pjesë personalisht, përfaqësuesve me autorizim³ të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, znj. M.R dhe znj. I.N, specialiste në Sektorin e Çështjeve Juridike Administrative dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar nga z. A.U, Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë të Bashkisë Vlorë, e cila edhe pse kishin marrë rregullisht dijeni nuk u paraqitën në seancë dhe nuk paraqiti ndonjë arsye objektive për mosparaqitjen.

³ Respektivisht: Autorizim me nr. 5474/1 prot., datë 06.09.2023 e MASR-së, Autorizim me nr. 15670/1 prot., datë 11.09.2023, të MFE-së

Nga ana e përfaqësuesit të MFE-së u mbajt qëndrimi se, institucioni që ai përfaqëson nuk duhet të ishte palë në këtë proces, me arsyetimin se edukatorët kanë varësi nga Ministria e Arsimit dhe Bashkia Vlorë. Në këtë kontekst ai mbajti qëndrimin se interpretimin e këtij akti, VKM-së mbi të cilën përcaktohet dhe paga e ankuësës, e bën vetë institucioni që e zbaton atë. Pra, Bashkia duhet të japë dhe shpjegimin se pse e zbaton në këtë mënyrë aktin në fjalë.

Përfaqësueset e MAS-it, u shprehen se: *“VKM-ja përcakton nivelet e pagave që duhet të marrin edukatorët dhe mësuesit në bazë të diplomës. Edukatorët kanë detyrim të kenë gradën “Bachelor”, mësueset duhet të kenë gradën “Master Shkencor”. Mësuesit duhet të kryejnë edhe trajnimet profesionale dhe provimin e shtetit. VKM-ja përcakton se kush është punësuar mbas datës 01.03.2017, do të paguhet me 11.000 lekë. ”* Pyetjes, nëse znj. R.N, e cila ka 30 vjet përvojë pune në arsim, konsiderohet ose jo punonjëse e re sipas VKM-së, përfaqësuesja e MAS, iu përgjigj se kjo pyetje i takon Bashkisë Vlorë, në cilësinë e punëdhënësit.

Në përfundim të seancës, palëve iu bë e ditur se mund të depozitonin në vijim të seancës, parashtrime, prova e fakte të tjera shtesë të cilat mbështesnin pretendimet e tyre.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 660/4 prot., datë 26.09.2023, Komisioneri iu drejtua Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Vlorë, duke kërkuar prej secilit institucion informacionin si më poshtë citojmë:

Nga ana e Këshillit të Ministrave:

- Informacion/relacion shpjegues lidhur me arsyet e diferencimit të mësuesve/edukatorëve për përfitimin e pagës së grupit sipas VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”*.
- Arsyet e vendosjes së këtij diferencimi, që lidhet me datën e zbatimit të VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017.

Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:

- Referuar faktit që Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për zbatimin e VKM-së me nr. 175, datë 08.03.2017 *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”*, a është kryer ndonjë monitorim lidhur me zbatimin e saj? Nëse po, të vihen në dispozicion të Komisionerit gjetjet e monitorimeve.

Nga ana e Bashkisë Vlorë:

- Informacion mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve/edukatore në kopshtet që mbulon Bashkia Vlorë. Sa prej tyre janë emëruar përpara vitit 2017 dhe sa prej tyre pas këtij viti?
- Informacion lidhur me numrin e punonjësve/edukatore të cilëve u është ulur paga e grupit dhe sa prej tyre jo. Nëse ka raste që nuk u është ulur paga e grupit, të specifikohen arsyet lidhur me të, për secilin prej tyre.

- A ka punonjëse/edukatore që janë transferuar pas vitit 2017 nga bashki të tjera apo brenda kopshteve të Bashkisë Vlorë dhe paga grupit për ta ka mbetur e pandryshuar? Nëse po, të jepen arsyet e mosndryshimit të pagës së grupit për secilin prej tyre.
- Informacion lidhur me arsyet përse u vendos ndryshimi i pagës së grupit për punonjëset/edukatore të arsimit parashkollor, në Bashkinë Vlorë, nga 14000 lekë në 11000 lekë, në muajin shkurt 2023, ndërkohë që VKM-ja nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, kishte efekt veprues që nga data 1 mars 2017.

6. Nëpërmjet shkresës me nr. 6079/1 prot., datë 03.10.2023, lidhur me sa më sipër, u përgjigj vetëm MAS, e cila ndër të tjera, u shpreh se:

“Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 23, pika 12, e tij, bashkitë janë përgjegjëse për administrimin dhe rregullimin e sistemit parashkollor në kopshte e çerdhe.

Me Urdhrin e Kryeministrit me nr. 127, datë 16.09.2015 “Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, numri i punonjësve mësimorë, edukatorë të arsimit parashkollor, numri i punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, si dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve të punonjësve mësimorë, edukatorë të arsimit parashkollor, punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, janë transferuar pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore.”

Sipas pikës 2, të kreut 12, të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar, për mësuesit në institucionet parashkollore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, kryejnë procedurat e emërimit duke respektuar renditjen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

Për sa më sipër, sqarojmë se MAS nuk kryen monitorime në lidhje me zbatimin e VKM nr. 175, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, përsa i përket strukturës së pagës të mësuesve të arsimit parashkollor.”

7. Nëpërmjet shkresës me nr. 660/6 prot., datë 06.11.2023, Komisioneri, iu drejtua sërish nëpërmjet një kujtese, Këshillit të Ministrave dhe Bashkisë Vlorë, lidhur me dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar prej tij.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR 458 920 723 AA, rezulton se shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga Këshilli i Ministrave, i cili ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar nga punonjësi i këtij institucioni, ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

Në vijim, Këshilli i Ministrave, pavarësisht faktit që ka marrë informacion, lidhur me shkresën e sipërcituar, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesave në fjalë.

Nëpërmjet shkresës me nr. 13670/1, datë 14.11.2023, Bashkia Vlorë, dërgoi informacionin si vijon:

“Në lidhje me informacionin e kërkuar, Bashkia Vlorë i është drejtuar MAS për interpretimin e VKM-së me nr. 175/2017 dhe ka mbajtur një korrespondencë vijuese lidhur me këtë fakt.

Problematika është evidentuar pas emërimit të një edukatoreje në Kopshtin nr. 2, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, e cila më parë ka qenë e emëruar në institucionet arsimore parashkollore në Bashkinë Berat.

...Kontrata e punësimit lidhej dhe vazhdon të lidhet midis drejtueses së institucionit arsimor dhe edukatores. Nga Bashkia Vlorë bëhet vetëm pagesa, e bazuar në listëprezencën e dorëzuar nga institucioni arsimor”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

A. Lidhur me pretendimin e ankueses, për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Vlorë.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Në këtë kontekst, në ankesën në fjalë, është analizuar dhe vlerësuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, pabarabartë e të pafavorshme nga Bashkia Vlorë, (në kuadër të legjitimitit si institucioni përgjegjës dhe kompetent lidhur me pagën e punonjësve të arsimit parashkollor/edukatorëve). Komisioneri ka vlerësuar dhe analizuar objektin e kësaj anese, lidhur me pretendimin e ankueses caktimin e pagës së grupit nga 11.000 lekë dhe jo 14.000 lekë, duke analizuar nëse veprimet e Bashkisë Vlorë janë të drejta, në përputhje me parashikimet ligjore dhe konkretisht VKM-në nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.

A. 1 Lidhur me zbatimin e VKM-së Nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, nga ana e Bashkisë Vlorë

Nga aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës rezultoi se:

Ankuesja R.N, punon si edukatore në Kopshtin Nr.2 “Sulo Didi”, institucion i arsimit parashkollor, i cili është në varësi të Bashkisë Vlorë. Rezulton se, ankuesja ka filluar punë në pozicionin që mban aktualisht “Edukatore” në Kopshtin Nr.2 “Sulo Didi”, në datë 03.10.2022, fakt ky që rezulton i provuar nga Kontrata individuale e punës, Nr.23 prot datë 29.09.2022, e lidhur midis ankueses dhe Kopshtit Nr.2, Vlorë (përfaqësuar nga drejtori i institucionit arsimor parashkollor /kopshtit) dhe marrëdhëniet e punës janë lidhur për një afat kohor të pacaktuar. Nga aktet e administruara figuron se, emërimi i ankueses si edukatore në Kopshtin Nr.2, Vlorë, është kryer, pas procedurave të ndjekura në Portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022 në ZVAP Vlorë-Himarë, bazuar në Udhëzimin nr.12, datë 10.06.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.

Ankuesja R.N është bërë pjesë e arsimit parauniversitar publik në datën 16.09.1988. Sipas shënimeve të pasqyruara në librezën e punës së ankueses, rezulton se, në datën 16.09.1988 ankuesja ka filluar punë si mësuese në Shkollës 8-vjeçare Qereshnik, Berat. Nga data 16.09.1988 deri në datën 10.06.2013, ankuesja ka punuar si mësuese në disa shkolla të arsimit 9 vjeçar në Berat, pa asnjë shkëputje por duke u transferuar si mësuese në shkolla të ndryshme. Në datën 11.06.2013, ankuesja ka filluar punë si edukatore në Kopshtin “28 Nëntori”, në Bashkinë Berat. Ankuesja ka vazhduar të punojë në këtë pozicion pune deri në datën 03.10.2022, kur është transferuar në pozicionin e punës të cilin e mban aktualisht “Edukatore në Kopshtin Nr.2, në Bashkinë Vlorë.

Nga aktet e administruara rezulton se, ankuesja disponon Diplomë të Nivelit të Parë në Mësuesi për “Arsim parashkollor”, lëshuar në vitin 2009 nga Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë si dhe Diplomë Master Profesional në Pedagogji me Profil Menaxhim Arsimi, lëshuar në vitin 2011, nga Universiteti Jo publik “Albanian University”.

Nga deklaratimet dhe dokumentacioni i depozituar nga palët është pranuar se, ankuesja në momentin e emërimit në pozicionin “Edukatore”, në Kopshtin Nr.2, Vlorë, me datë 03.10.2022 i është përcaktuar nga ana e Bashkisë Vlorë, paga e grupit 11.000 lekë.

Ankuesja nuk ka qenë dakort me pagën e grupit prej 11.000 lekë të përcaktuar nga Bashkia Vlorë dhe ka paraqitur ankesë, duke pretenduar se duhet të paguhej me pagë grupi 14.000 lekë, pasi ajo nuk ishte punonjëse e re por kishte 35 vjet punë në arsim dhe kishte shkuar edukatore në Bashkinë Vlorë me lëvizje paralele nga portali “Mësues për Shqipërinë”

Ankuesja ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar nga ana e Bashkisë Vlorë, për shkak të “gjendjes arsimore”.

Neni 28⁴, i ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 23⁵, i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4, e Urdhrit të Kryeministrit me nr. 127, datë 16.0.2015 “Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, kanë përcaktuar se, numri i punonjësve mësues/edukatorë të arsimit parashkollor, numri i punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, si dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve të punonjësve mësues, edukatorë të arsimit parashkollor, punonjësve të shërbimeve në arsimin parauniversitar, janë transferuar dhe janë në kompetencë të njësisë të vetëqeverisjes vendore.

⁴ Neni 28 “Njësia bazë e qeverisjes vendore”:

“1. Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë:

a) ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transferat e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;
b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;
c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;
ç) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.

3. Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.

4. Njësia bazë e qeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e njësisë arsimore vendore dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësisë vendore, mbështet:

a) nxënësit e familjeve në nevojë;
b) nxënësit me arritje të shkëlqyera;
c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës;
ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.

⁵ Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:...

12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.”

Arsimi parauniversitar, është ristrukturuar, duke i kaluar në varësi të bashkive, gjithë punonjësit e kopshteve (edukatorët) dhe gjithë personelin mirëmbajtës të shkollave 9 vjeçare dhe gjimnazeve. Me buxhetin e vitit 2016, janë transferuar në nivel vendor funksionet e kompetencat lidhur me personelin mësimor dhe jo mësimor në arsimin parashkollor.

Vendimi i Qeverisë për decentralizimin e funksionit të arsimit specifikon transferimin e personelit mësimor në arsimin parashkollor (kopshte) dhe personelin jomësimor në arsimin parauniversitar. Në kuadër të decentralizimit të këtij funksioni, 7101 punonjës u transferuan nën kompetencat e bashkive në vitin 2016. Transferimi i shërbimeve arsimore së bashku me numrin e punonjësve që ofrojnë këto shërbime është shoqëruar me efektet financiare prej 4.3 miliard lekë.

Urdhri i Kryeministrit me nr.127, datë 16.09.2015, lidhur me transferimin e numrin e punonjësve në arsimin parashkollor, edukatore në kopshtet e fëmijëve, numrin e punonjësve të shërbimeve ndihmëse në arsimin 9-vjeçar ku përfshihet dhe numri i punonjësve të qendrave kulturore të fëmijëve, numrin e punonjësve të shërbimeve mbështetëse në arsimin e mesëm të përgjithshëm "gjimnazet", ka përcaktuar dhe fondet e parashikuara për mbulimin e shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore).⁶

Bazuar në sa më sipër, institucioni që ka kompetencën për pagën e punonjësve mësimorë/edukatorë në arsimin parashkollor është njësia vendore/bashkia. Në rastin konkret, objekt gjykimi është Bashkia Vlorë.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se përsa i takon pretendimit për uljen e pagës së grupit të edukatoreve të arsimit parashkollor, gëzon legjitimitet pasiv para Komisionerit, vetëm Bashkia Vlorë dhe jo MFE.

Për rrjedhojë, Bashkia Vlorë, në tagrin e institucionit përgjegjës lidhur me pagën e ankueses (punonjësve mësimorë/edukatorë në arsimin parashkollor), ka argumentuar se, (pavarësisht momentit të zbatimit të aktit nënligjor që përcakton pagën e grupit për punonjësit e arsimit parashkollor) se një ndryshim i tillë në pagën e ankueses, ka ardhur si rezultat i zbatimit të VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 "*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar*", të ndryshuar, për caktimin e pagave të punonjësve të arsimit parashkollor/edukatorëve, për pasojë edhe të ankueses si pjesë e kësaj kategorie.

Nga dokumentacioni i depozituar nga palët në proces, evidentohet se nga ana e Bashkisë Vlorë është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme përmes korrespondencës shkresore, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, interpretim i kësaj VKM-je me qëllim zbatimin e saj korrekt dhe në përputhje me sa është përcaktuar.

⁶ https://www.bpe.al/sites/default/files/documents/Raport-Studimor-DLDP-Monitorim-i-I-Strategjia-Decentralizimit-te-QV-2016-1_0.pdf

Me shkresën me nr. 1024 prot., datë 25.01.2023, Bashkia Vlorë i është drejtuar MAS, më kërkesën për interpretim lidhur me sa më poshtë vijon:

1. Me cilin grup të pagës do të paguhet një edukatore me diplomë “Bachelor” dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe e siguruar në institucionet arsimore publike deri në datën 1 mars 2017, ka shkëputur marrëdhënien e punës tashmë po punësohet në një institucion arsimor publik pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”.
2. Me cilin grup të pagës do të paguhet një edukatore me diplomë “Bachelor” dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe e siguruar në institucionet arsimore publike deri në datën 1 mars 2017, ka shkëputur marrëdhënien e punës tashmë po punësohet në një institucion arsimor publik, krahas diplomës “Bachelor” ka kryer edhe “Master Shkencor”.
3. Me cilin grup të pagës do të paguhet një edukatore me diplomë “Bachelor” dega parashkollor 2006-2009 e cila ka qenë e punësuar dhe e siguruar në institucionet arsimore publike, si psh Berat deri në datën 03.10.2022, dhe po në datën 03.10.2022 transferohet në portal dhe punësohet në një institucion arsimor publik në Vlorë dhe ka kryer “Master Profesional”;
4. Mësuese ndihmëse me diplomë “Bachelor” me “Master Profesional” paga e grupit 11.000 lekë apo 14.000 lekë?

Në vijim të kërkesës së Bashkisë Vlorë, nëpërmjet shkresës me nr. 616/1 prot., datë 08.02.2023, MAS, ka sqaruar ndër të tjera, Bashkinë, duke argumentuar se:

- Në lidhje me pagën e diplomës, VKM në fjalë, ka përcaktuar se: Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë deri para datës 1 mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14.000 lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin përkatës. Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punën për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2, të VKM-së.
- Në përgjigje të pikës 1 dhe 4, të kërkesës tuaj, sqarojmë se, në zbatim të VKM-së në fjalë, është përcaktuar se: Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë deri para datës 1 mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14.000 lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin përkatës.
- Në përgjigje të pikës dy dhe tre tuaj, sqarojmë se, bazuar në nenin 57, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar, në këtë program arsimor (edukatore) nuk kërkohet kualifikimi i nivelit të dytë në “Master Profesional apo Shkencor”. Punonjësit arsimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 2, të VKM-së.

- Ndaj sa më sipër, këkojmë nga ana juaj klasifikimin e pagave të punonjësve sipas VKM së nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”.

Me shkresën me nr. 1024/2 prot., datë 16.03.2023, Bashkia Vlorë, i është drejtuar sërish MAS, lidhur me nevojën për të qartësuar qëndrimin, interpretimin e tyre, ndër të tjera, lidhur me, paragrafin: “...do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të diplomës...”, duke informuar MAS, se: “...Jemi të paqartë lidhur me këtë paragraf, pasi në institucionet arsimore të Bashkisë Vlorë ka edukatore të cilat kanë përditësuar dosjen me diplomë “Master Shkencor” dhe “Master Profesional”, dhe pretendojnë të përfitojnë pagën e grupit në masën 14.000 lekë.”

Në përgjigje të sa më sipër, MAS, me shkresën me nr. 616/3 prot., datë 29.03.2023, ka dërguar pranë Bashkisë Vlorë të njëjtën përgjigje që ka përcjellë me datë 08.02.2023, me shkresën me nr. 616/1 prot.

Është pranuar nga palët se, ndryshimi i masës së pagës së grupit për ankuesen është reflektuar për herë të parë (që nga emërimi i saj në detyrë me datë 10.05.2023) në muajin shkurt 2023.

Në lidhje me pagesën mujore të punonjësve të arsimit parashkollor/edukatorëve, për pasojë edhe të ankueses si pjesë e kësaj kategorie, sipas nivelit të arsimimit të tyre, Komisioneri vëren se, paga mujore e tyre, përllogaritet, mbështetur në kriteret e përcaktuara në pikën 3, të VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar ”, të ndryshuar, ku përcaktohet se, “Struktura e pagës mujore” përbëhet nga:

“3. Struktura e pagës mujore përbëhet nga:

3.a) paga e grupit (kolona 2 e lidhjeve nr. 1, nr. 2 e nr. 3), që është paga për nivelin arsimor të kërkuar, vlera e së cilës përcaktohet sipas lidhjes nr. 4 , “Paga për nivelin arsimor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri para datës 1 mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin arsimor përkatës.

Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 4 të vendimit.

3.b) shtesa për vjetërsi pune (kolona 3 e lidhjeve nr. 1, nr. 2 e nr. 3), që aplikohet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, por jo më shumë se 25 vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi pagën e grupit. Për

efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

3.c) shtesa për kualifikim (kolona 4 e lidhjeve nr. 1 e nr. 3), që jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit, në përqindje, si më poshtë vijon:

- a) 5% të pagës së grupit, pas përfitimit të shkallës “Mësues i kualifikuar”;
- b) 10% të pagës së grupit, pas përfitimit të shkallës “Mësues specialist”;
- c) 20% të pagës së grupit, pas përfitimit të shkallës “Mësues mjeshtër”.

Shtesa për kualifikim (kolona 4 e lidhjes nr. 2), është 0.

3.ç) shtesa e pozicionit, (kolona 5 e lidhjeve nr. 1, nr. 2 e nr. 3) që është e përcaktuar për çdo vend pune, sipas emërtesës përkatëse të pozicionit të punës.”

Lidhja nr.3, e kësaj VKM-je, e cila rregullon strukturën e pagës, për punonjësit mësimorë të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe konvikteve të nxënësve, përcakton respektivisht në numrat rendor 8 dhe 9, dy kategori page grupi, për pozicionin “Edukator në kopësht fëmijësh”. Pozicioni “Edukator në kopësht fëmijësh” që i korrespondon numrit rendor 8, e ka pagën e grupit 1 (që i korrespondon shuma 14, 000 lekë në muaj), kurse pozicioni me të njëjtin emërtim “Edukator në kopësht fëmijësh” që i korrespondon numrit rendor 9, e ka pagën e grupit 2 (që i korrespondon shuma 14, 000 lekë në muaj).

Lidhja nr. 4, e kësaj VKM-je, përcakton: “Paga për nivelin arsimor”, sipas tabelës:

Grupi		Niveli i diplomës	Shuma lekë në muaj
Grupi 1	Mësuesi i arsimit fillor, mësuesi i arsimit të mesëm të ulët dhe mësuesi i gjimnazit: Mësuesi i shkollave të arsimit profesional, që jep lëndë profesionale, ai i arsimit të orientuar dhe mësuesi, që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara	Diplomë e ciklit të dytë të studimeve universitare apo të barasvlershme me to sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin	14, 000
Grupi 2	Mësuesi i arsimit parashkollor	Diplomë universitare të ciklit	11,000

		të parë të studimeve universitare “Bachelor” apo të barazvlefshme me to sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për përgjegjësinë për arsimin.	
--	--	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--

Nëni 57, i ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se: “Mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor.”

Komisioneri vëren se, në lidhje me pagën sipas kriterit arsimor/diplomës së zotëruar, VKM me nr. 351, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime në “ VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, përcakton se:

“Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë, të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, ose të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri para datës 1 mars 2017, kanë përfutur pagën e grupit në masën 14.000 lekë, do të vazhdojnë të përfutojnë të njëjtën masë të pagës së grupit, deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin përkatës.

Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punën për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar, pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr.2, të VKM-së”.

Në momentin e miratimit VKM Nr.175, datë 8.3.2017, nuk përmbante asnjë diferencim midis punonjësve mësimorë/edukatorë, kushtëzuar nga fakti nëse ata kishin filluar punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar, para apo pas datës 1 mars 2017. Sipas VKM-së Nr.175, datë 8.3.2017, të gjithë punonjësit mësimorë/edukatorë, do të paguheshin me pagë grupi 11.000 lekë. Rreth një muaj e gjysëm pas miratimit të VKM Nr.175, datë 8.3.2017, Këshilli i Ministrave miratoi VKM nr.351, datë 19.04.2017, akt nëpërmjet të cilit u vendos diferencimi i punonjësve mësimorë/edukatorë, si më sipër pasqyruar.

Komisioneri, bazuar në sa më sipër, konstaton se, lidhur me ushtrimin e profesionit si punonjës mësimor/edukator, nuk kërkohet kualifikimi i nivelit të dytë master, pra, punonjësit mësimorë në arsimin parashkollor, edukatorë, që zotërojnë diploma të nivelit të dytë “Master profesional” apo “Master shkencor”, dhe për rrjedhojë ata nuk përfutojnë shtesë page, pasi për emërimin në këtë pozicion nuk kërkohet një kualifikim i tillë.

Për analogji e njëjta logjikë arsyetuese vlen edhe për punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parashkollor pas datës 1 mars 2017.

Lidhur me situatën faktike të ankueses, Komisioneri vëren se, marrëdhënia e punës si punonjëse mësimore/edukatore në arsimin parauniversitar publik për ankuesen R.N, ka nisur në datën me datë 16.09.1988, kur ankuesja ka filluar punë si mësuese në një shkollë 8 vjeçare në Berat. Ankuesja ka filluar për herë të parë si punonjëse mësimore/edukatore në arsimin parashkollor në datën 11.06.2013, kur ka filluar punë si edukatore në Kopshtin “28 Nëntori”, në Bashkinë Berat, pozicion në të cilin ka vazhduar të punojë pa ndërprerje deri në datën 03.10.2022, kur është transferuar në pozicionin e punës “Edukatore” në Kopshtin Nr.2, në Bashkinë Vlorë.

Rezulton se, që nga momenti kur ankuesja ka filluar punë për herë të parë si mësuese në vitin 1988 dhe si edukatore në kopësht fëmijësh në vitin 2013, ajo nuk ka asnjë shkëputje nga puna në sistemin arsimor parauniversitar publik, por vetëm ka kryer lëvizje brenda sistemit duke ndryshuar pozicionet e saj të punës. Nga aktet e administruara, rezulton që, në asnjë moment ankuesja R.N të ketë ndërprerë marrëdhënien e punës si punonjëse mësimore/edukatore në sistemin arsimor parauniversitar, sikurse rezulton edhe nga shënimet e vendosura në librezën e saj të punës, ku ndyshimi i pozicioneve të punës, qoftë si mësuese, qoftë si edukatore, është pasqyruar si kalim ose transferim në detyrë tjetër.

Gjithashtu, lidhja e kontratës së punës midis ankueses dhe Kopshtit Nr.2, Vlorë në pozicionin e punës që ankuesja mban aktualisht që prej datës 03.10.2022, është kryer në përfundim të procedurave të ndjekura sipas udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit *“Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”*, i ndryshuar. *(në vijim Udhëzimi i MAS Nr.12, datë 10.06.2021, i ndryshuar).*

Në pikën 1 dhe 2, të Kreut 5 *“Aplikimi dhe procedura e vlerësimit të dosjeve për kandidatët e arsimit parashkollor”*, të Udhëzimit të MAS Nr.12, datë 10.06.2021, të ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Kandidatët e profilit të arsimit parashkollor aplikojnë në portal sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi. 2. Kandidatët e profilit të arsimit parashkollor dërgojnë me postë në ZVAP ku kanë vendbanimin, dosjen sipas shtojcës 1 të cilën e kanë ngarkuar online, sipas afateve të përcaktuara.”*

Në pikën 2, të Kreut 12 *“Dispozita kalimtare dhe të fundit”*, të udhëzimit të sipërcituar, përcaktohet se: *“2. Për mësuesit në institucionet parashkollore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e emërimit duke respektuar renditjen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.*

Me shkresën e datës 29.09.2023 me lëndë *“Mbi lidhjen e kontratës me afat të pacaktuar”* Bashkia Vlorë i është drejtuar Kopshtit Nr.2, Vlorë, ndër të tjera, si vijon: *“ Të lidhet kontratë me afat të pacaktuar me aplikantin z/znj R.N, portali “Parashkollor” i/e renditur në portal i/e 1 me pikë totale 82.8. Marrëdhënia juridike e financiare të fillojë në datën 03.10.2022”*. Në të njëjtën ditë, pra në datë 29.09.2022 është lidhur kontrata individuale e punës midis ankueses dhe Kopshtit Nr.2,

Vlorë. Në momentin e nënshkrimit të kontratës me Kopshtin Nr.2, Vlorë, ankuesja ka qenë punonjëse që ka filluar punën për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar, para datës 1 mars 2017 dhe konkretisht ajo ka filluar punë si edukatore, në datën 13.01.2013.

Në çdo rast punonjësit të cilët kanë filluar punë për herë si punonjës mësimorë edukatorë në arsimin parauniversitar para datës 1 mars 2017 kur bëjnë lëvizje vullnetare ose të detyrara duke ndryshuar pozicionet e ndryshme brenda sistemit arsimor parauniversitar detyrimisht do të nënshkruajnë një kontratë të re pune me institucionin arsimor parauniversitar, por kjo nuk e ndryshon statusin e tyre duke i konsideruar ata si punonjës që kanë filluar punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar.

Pra, momenti kohor i fillimit të marrëdhënieve të punës për ankuesen daton para 1 marsit 2017 dhe rrjedhimisht ajo nuk mund të konsiderohet si punonjëse që fillon punën për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar, pas datës 1 mars 2017, që do të përlligjte sipas përcaktimeve të pikës 3/a, të VKM Nr.175/08.03.2017, të ndryshuar, trajtimin e saj me pagë grupi 11.000 lekë. Referuar pikës 3/a, të VKM-së Nr.175/08.03.2017, të ndryshuar lexuar së bashku me parashikimet e lidhjes 4, të po kësaj VKM-je, do të paguhet me pagë grupi 11.000 lekë vetëm punonjësit edukatorë, të cilët kanë filluar punë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parashkollor pas datës 1 mars 2017.

Ankuesja e cila ka filluar punë si punonjëse mësimore/ edukatore në arsimin parashkollor para datës 1 mars 2017, nuk i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, por ajo është sistemuar brenda sistemit duke ndryshuar pozicionin e punës, por pa dalë nga sistemi dhe pa ndërprerë marrëdhënien e punës me institucionin përkatës arsimor. Nëse ankuesja do të kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me një nga institucionet përkatëse arsimore ku ajo ka qenë e punësuar pas datës 01.03.2017, duke dalë kështu nga sistemi arsimor parauniversitar publik për të rihyrë në sistemin arsimor parauniversitar në datën 03.10.2022, pra në momentin e nënshkrimit të kontratës me Kopshtin Nr.2, Vlorë, atëherë ajo ajo mund të konsiderohej si punonjëse mësimore/edukatore që fillonte punë për herë të parë. Ankuesja, që prej datës 11.06.2023, kur ka filluar punë si edukatorë në Kopshtin 28 Nëntori, Berat e në vazhdim, nuk e ka ndërprerë asnjëherë marrëdhënien e punës me institucionin arsimor përkatës ku ajo ka punuar gjatë kësaj periudhe kohore, por lidhja e kontratës së re të punës me Bashkinë Vlorë, ka ardhur si rezultat i lëvizjeve të brendshme në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet Portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Në analizë e konkluzion të sa më sipër, Komisioneri thekson se nga ana e Bashkisë Vlorë, si institucioni përgjegjës dhe kompetent lidhur me pagën e punonjësve mësimorë/edukatorë në arsimin parashkollor, për rrjedhojë edhe të ankueses, si edukatore në kopësht fëmijësh, nuk është zbatuar në mënyrë të drejtë pika 3.a), e VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, që ka përcaktuar edhe vlerën e pagës së grupit për këtë kategori të punonjësve mësimorë/edukatorë të cilët kanë nisur marrëdhënien e tyre të punës para datës 1 mars 2017, sikurse rasti i ankueses

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë Vlorë, pasi, paga e grupit e caktuar nga Bashkia Vlorë në momentin kur ajo ka filluar punë si “Edukatore” në Kopshtin Nr.2, Vlorë, vjen në kundërshtim me VKM Nr.175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, duke e konsideruar në mënyrë të padrejtë ankuesen si punonjëse që ka filluar punën për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar, pas datës 1 mars 2017.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkaku i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Në çështjen objekt shqyrtimi, ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të “*gjendjes arsimore*”.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, *gjendja ekonomike, arsimore, sociale* ose përkatësia prindërore.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë shkakun e *gjendjes arsimore*, të pretenduar nga ankuesja.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*” Komisioneri gjykon se “*gjendja arsimore*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD. *Gjendja arsimore*, si shkak i ndaluar diskriminimi, nënkupton nivelin individual të arsimimit, arrijet në arsim, aftësitë apo certifikatat në lidhje me arsimin, të një personi.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur “gjendja arsimore”.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “*Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori*

personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Sipas GJEDNJ-së, "diskriminim i drejtpërdrejtë" është një "ndryshim në trajtimin e personave në situata të njëjta ose të ngjashme" që "bazohet në një karakteristikë të identifikueshme ose "status/shkak" të mbrojtura nga Neni 14 i Konventës"⁷. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga neni 14 i KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme (diskriminimi i tërthortë)⁸.

LMD (neni 1) e përkufizon diskriminimin si *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, ku ndër të tjera përfshihet edhe shkak i gjendjes arsimore, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 3, pika 2 dhe 7 të tij, LMD përcakton se: *"2. Diskriminim i drejtpërdrejtë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.....7. Diskriminim i tërthortë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë."*

Kërkimin e saj për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, ankuesja e bazon në pretendimin se duhet të paguhet me pagë grupi prej 14. 000 lekë, në mënyrë të barabartë me kolegët që kryejnë të njëjtën punë, në të njëjtin pozicion dhe me të njëjtin nivel diplome, në qytete të tjera, pasi praktika e kundërshtuar nga ankuesja sipas saj zbatohet vetëm në Bashkinë Vlorë.

⁷ GJEDNJ: *Biao kundër Danimarkës* [GC], 2016; *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], 2010; *Varnas kundër Lituanisë*, 2013.

⁸ GJEDNJ: *Thlimenos kundër Greqisë* [GC] (Nr. 34369/97), 6 Prill 2000.

Bazuar në pretendimin për diskriminim të paraqitur nga ankuesja, si dhe në faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, çështja objekt shqyrtimi duhet të analizohet në raport me përcaktimin e nenit 3, pika 2, të LMD, për të vlerësuar nëse ndodhemi në kushtet e diskriminimit të drejtëpërdrejtë për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

Nga sa më sipër, përcaktohet se ata persona të cilët janë në situata të njëjta ose të ngjashme duhet të kenë trajtim të njëjtë dhe nuk duhet të trajtohen në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme për shkak të një karakteristike/shkaku të veçantë, “*të mbrojtur*”, që ata kanë. Pra, diskriminimi i drejtëpërdrejtë ndodh kur:

- një person është trajtuar në mënyrë të pafavorshme;
- në krahasim me mënyrën se si janë trajtuar, trajtohen apo do të trajtoheshin të tjerët, në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë është një karakteristikë e veçantë që ata kanë, e cila përfshihet në një nga shkaqet e mbrojtura të diskriminimit.

Komisioneri thekson se, trajtimi i diferencuar dhe i pafavorshëm, përcaktohet si diskriminim në rastet kur ai është i pafavorshëm, si rezultat i krahasimit të personit që pretendon se është diskriminuar me një person në një situatë të njëjtë ose të ngjashme. Për rrjedhojë, nevojitet një “krahases”, një person në rrethana të njëjta ose të ngjashme, ku ndryshimi kryesor ndërmjet dy personave, ankuesit dhe krahasuesit, është “shkaku i mbrojtur”. Pra, është e nevojshme që të shqyrtohet nëse trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm, ka ardhur si rezultat i shkakut të mbrojtur që personi i cili pretendon se është diskriminuar e mbart dhe që krahasuesi nuk e mbart, dhe njëkohësisht shkaku që pretendohet, mbrohet nga legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi, konkretisht nga LMD.

Në ankesën objekt shqyrtimi ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore, pra sipas saj, trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm ndaj të cilit e ka ekspozuar Bashkia Vlorë, duke caktuar pagën e grupit 11.000 lekë dhe jo 14.000 lekë, ka ardhur për shkak të gjendjes arsimore. Ankuesja pretendon se po trajtohet në mënyrë të diferencuar dhe më pak të favorshme në raport me kolegë të tjerë në qytete të tjera të cilët kanë të njëjtin nivel arsimor sikurse ankuesja, por ndryshe nga ajo paguhen me pagë grupi 14.000 lekë.

Sa më sipër rezultoi se ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga Bashkia Vlorë pasi, paga grupit në masën 11.000 lekë është përcaktuar në kundërshtim me VKM Nr.175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar*”, të ndryshuar.

Gjendja arsimore, pretenduar nga ankuesja si shkak diskriminimi, përbën gjithashtu një shkak i cili mbrohet nga LMD. Por, nga ana tjetër konstatohet se, gjendja arsimore e ankueses, sikurse edhe pretendohet nga vetë ajo nuk rezulton që të jetë shkaku i trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm

ndaj të cilit ajo është ekspozuar nga Bashkia Vlorë. Ankuesja pretendon se edhe kolegët e tjerë me të cilët ajo krahasohet, që në rastin konkret, në funksion të analizës së diskriminimit do të konsiderohen si “krahasuesi”, edhe pse nuk janë identifikuar si persona, kanë të njëjtën gjendje arsimore. Në këto kushte, nuk është gjendja arsimore e ankueses shkak për trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm ndaj të cilit ajo është ekspozuar nga Bashkia Vlorë. Personat me të cilët ankuesja krahasohet, sipas pretendimeve të ankueses, mbartin të njëjtin shkak sikurse ankuesja. Shkak i pretenduar i diskriminimit, në rastin konkret, gjendja arsimore, duhet të ishte ndryshimi kryesor midis ankueses dhe personave me të cilët ajo krahasohet, çka nuk rezulton të jetë kështu.

Në ankesën objekt shqyrtimi ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore, pra sipas saj trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm ndaj të cilit e ka ekspozuar Bashkia Vlorë, duke i caktuar pagën e grupit 11. 000 lekë dhe jo 14. 000 lekë, ka ardhur për shkak të gjendjes arsimore. Ankuesja pretendon se po trajtohet në mënyrë të diferencuar dhe më pak të favorshme në raport me kolegë të tjerë me të cilët kanë të njëjtin nivel arsimor sikurse ankuesja, por, ndryshe nga ajo, kolegët me të cilët krahasohet ankuesja paguhen me pagë grupi 14.000 lekë dhe jo 11.000 lekë.

Sa më sipër rezultoi se ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga Bashkia Vlorë pasi, paga e grupit e caktuar nga Bashkia Vlorë në momentin kur ajo ka filluar punë si “Edukatore” në Kopshtin Nr.2, Vlorë, vjen në kundërshtim me VKM Nr.175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, duke e konsideruar në mënyrë të padrejtë ankuesen si punonjëse që ka filluar punën për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar, pas datës 1 mars 2017.

Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, nuk mund të çojnë *apriori* në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk provohet lidhja shkakësore, pra se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i ankueses ka ardhur si pasojë e “shkaku i mbrojtur”, në rastin konkret gjendjes së saj arsimore.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, pavarësisht se Bashkia Vlorë e ka trajtuar ankuesen R.N, në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, pretendimet objekt shqyrtimi, nuk përbëjnë diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, në kuptim të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses R.N, për shkak të “*gjendjes arsimore*” në të drejtën për punësim, nga ana e Bashkisë Vlorë.
2. Komisioneri rekomandon Bashkinë Vlorë që të marrë masa për të rivendosur në vend të drejtën e ankueses R.N, duke e përlogaritur pagën e saj bazuar në pagën e grupit 14.000 lekë, duke e konsideruar ankuesen si punonjëse që ka filluar punën për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar, para datës 1 mars 2017, sipas përcaktimeve të VKM Nr.175, datë 08.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar*”, të ndryshuar.
3. Bashkia Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimit.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: gjendja arsimore
Fusha: punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim